Me kërkesën e Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, për ndarjen e mjeteve financiare për kryerjen e obligimeve ndaj Marrëveshjes së Mirëkuptimit ndërmjet Komunës së Deçanit dhe Programit të Kombeve të Bashkuara për Vendbanimet Njerëzore (UN-HABITAT) si dhe Aneks Marrëveshjes, participim në projektin e përbashkët "Porta e Turizmit Malor të Deçanit"-Konkurs Ndërkombëtar i Projektimit, në shumën totale 85,914.00 €, në bazë të dispozitave të nenit 17 dhe nenit 40 paragrafi 40.2 shkronja (b) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr.28/2008), si dhe nenit 26 pika 2. të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5, dt.31.10.2019, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.30.04.2026, me 19 vota"për", 2 vota "abstenim" dhe 0 votë "kundër", miratoi këtë:

# V E N D I M

## PËR MIRATIMIN E MJETEVE FINANCIARE SI PARTICIPIM I KOMUNËS SË DEÇANIT ME PROGRAMIN E KOMBEVE TË BASHKUARA PËR VENDBANIMET NJERËZORE (UN-HABITAT) NË PROJEKTIN E PËRBASHKËT "PORTA E TURIZMIT MALOR TË DEÇANIT"

**I.** Miratohen mjetet financiare për kryerjen e obligimeve ndaj Marrëveshjes së Mirëkuptimit ndërmjet Komunës së Deçanit dhe Programit të Kombeve të Bashkuara për Vendbanimet Njerëzore (UN-HABITAT) si dhe Aneks Marrëveshjes, participim në projektin e përbashkët "Porta e Turizmit Malor të Deçanit"-Konkurs Ndërkombëtar i Projektimit,, në shumën totale 85,914.00 €
Mjetet finaciare do të derdhen në konton e UN-HABITAT, sipas dokumnetacionit që do ti bashkëngjiten këtij vendimi.

II. Mjetet financiare, si në pikën I. të këtij vendimi ndahen nga linja buxhetore e Zyrës së Kryetarit ose Drejtoria për Buxhet dhe Financa, nga kategoria e subvencioneve.

III. Për realizimin e këtij vendimi do të kujdesen:Zyra e Kryetarit, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit të KK Deçan.

IV. Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

V. Me vendim njoftohen: Organizata UN-HABITAT, Zyra e Kryetarit, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Arkivi i Komunës së Deçanit.

01.Nr.IV-5
Deçan, dt.30.04.2026

Kuvendi Komunal 9025
01 13-05-26

Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN

DEÇANI

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2, shkronja d), nenit 40 paragrafi 40.2 shkronja (b) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr.28/2008), nenit 26 pika 2 të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5, dt.31.10.2019, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.30.04.2026, me 21 vota "për" 0 "kundër" dhe 0 "abstenim", miratoi këtë:

# V E N D I M

## PËR RRITJEN E BUXHETIT KOMUNAL TË VITIT 2025 NGA TË HYRAT VETANAKE TË VITIT 2025

I.

Miratohet Vendimi për rritjen e Buxhetit Komunal të vitit 2025 nga të hyrat vetanake të vitit 2025, në shumën prej 168,706.16 €, dhe orientohen në kategorinë Mallra dhe Shërbime, në kodin buxhetor 21/631/16015/130/00000/0111.

Kjo nënkupton se nga tejkalimi i inkasimit të hyrave vetanake në shumën prej 168,706.16 €, shuma e planifikuar e të hyrave vetanake e vitit 2025, e cila ka qenë 900,571.00 €, rritet dhe bëhet 1,069,277.16 €.

II.

Për ekzekutimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa e Komunës së Deçanit.

III.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në web faqen e Komunës.

IV.

Me Vendim njoftohen:MF-Departamenti i buxheteve Komunale, si dhe të gjitha organet kompetente të Komunës së Deçanit.

01.Nr.IV-2
Deçan, dt.30.04.2026

Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ

Kuvendi Komunal 9027
01 13.05.26

Në bazë të kërkesës së Komunitetit të fshatit Dobovik të paraqitur përmes Kryetarit të Këshillit të fshatit, z.Xhevdet Berisha, të dt.05.11.2025, nr.01-31131, për ndarjen e hapësirës për ndërtimin e objektit dhe hapësirës për shfrytëzim të parkingut për nevoja të komunitetit të fshatit Dubovik, duke u bazuar në dispozitat e nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja d), nenin 14 paragrafi 14.1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr.28/2008), në bazë të nenit 22 dhe 26 pika 7 të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5, dt.31.10.2019, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.30.12.2024, me 17 vota "për", 0 votë "kundër" dhe 0 votë "abstenim, miratoi këtë:

# V E N D I M

## PËR NDARJEN E HAPËSIRËS PËR NDËRTIMIN E OBJEKTIT DHE HAPËSIRËS PËR SHFRYTËZIM TË PARKINGUT PËR NEVOJA TË KOMUNITETIT TË FSHATIT DUBOVIK

I.

Me këtë Vendim bëhet ndarja e hapësirës për ndërtimin e Objektit për nevoja të komunitetit të fshatit Dubovik dhe hapësirës për shfrytëzim të parkingut të objektit për nevoja të komunitetit të fshatit Dubovik.

II.

Hapësira për ndërtimin e Objektit për nevoja të komunitetit të fshatit Dubovik dhe hapësirës për shfrytëzim të parkingut të objektit për nevoja të komunitetit të fshatit Dubovik ndahet nga Njësia Kadastrale me numër: P-70511031-00319-0, me sipërfaqe të përgjithshme prej S=4463m$^2$, në pronësi të Komunës së Deçanit, objekti që do të ngritët do të jetë përdhese në hapësirën prej 220m$^2$, ndërsa hapësira që ndahet për parking është 230m$^2$, Zona Kadastrale Dubovik.

III.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Zyra e Kryetarit të Komunës, Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinorë dhe Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër e Komunës së Deçanit.

IV.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale , si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

V.

Pjesë përbërse të këtij vendimi janë :

- Skica grafike,
- Kopjet e planit dhe
- Certifikatat e njësisë kadastrale.

VI.

Me Vendim paisen: Komuniteti i fshatit Dubovik, Zyra e Kryetarit të Komunës, Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinorë, Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër dhe Arkivi i Komunës së Deçanit.

01.Nr.IV-9
Deçan,dt.30.04.2026

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT

Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ

Kuvendi Komunal 9023
01 13.05.26

| | |
|---|---|
| Për/To/Za : | z.Bashkim Ramosaj, Kryetar i Komunës<br><br>z.Hajdar Sutaj, Kryesues i Kuvendit të Komunës<br><br>Anëtarët e Kuvendit të Komunës |
| Nga/From/Od | z.Xhevdet Berisha, Kryetar i Këshillit të fshatit Dubovik |
| Tema/Subject/Subjekat | Kërkesë për ndarjen e hapësirës për ndërtimin e objektit dhe hapësirës për shfrytëzim të parkingut për nevoja të komunitetit të fshatit Dubovik |
| Data | 04.11.2025 |

Të nderuar,

Ju drejtohem me këtë kërkesë në emër të komunitetit të fshatit Dubovik.

Kërkesa e komunitetit drejtuar juve është për ndarjen e hapësirës për ndërtimin e objektit dhe hapësirës përcjellëse për shfrytëzim të parkingut, për nevoja të komunitetit të fshatit Dubovik.

Komuniteti i fshatit Dubovik është në kërkim të një zgjidhje për ndërtimin e një Objekti të fshatit i cili do të plotësonte disa nga nevojat e domosdoshme për komunitetin, siç janë:

- Organizimin e takimeve të Këshillit Lokal,
- Organizimin e aktiviteteve të ndryshme kulturore,
- Organizmin e takimeve me mërgimtarët dhe takimeve tjera me interes për komunitetin,
- Organizimin e darkave tradicionale,
- Organizimin e pritjeve të Odave tona tradicionale.

Në konsultim me komunitetin kemi vlerësuar dhe jemi dakorduar se një hapësirë e përshtatshme për ndërtimin e këtij objekti do të ishte hapësira e evidentuar në Njësinë Kadastrale P-70511031-00319-0, me sipërfaqe të përgjithshme prej 4463 $m^2$, në pronësi të Komuna e Deçanit, Zona Kadastrale Dubovik.
Objekti që pretendojmë ta ndërtojmë do të jetë përdhese dhe hapësira e nevojshme për objekt dhe parking është sipërfaqja prej 450 $m^2$.
Të gjitha shpenzimet për ndërtimin e objektit i merr përsipër komuniteti i fshatit Dubovik.
Në rast të miratimit të kësaj kërkese nga ana e Kuvendit të Komunës, shënjimin e hapësirës duhet ta bëjnë shërbimet profesionale të Komunës së Deçanit.

Me respekt,

Xh. Berisha 31131
01 05.11.25

**Republika e Kosovës**

**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

***Qeveria - Vlada - Government***

***Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor / Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja / Ministry of Environment and Spatial Planning***

**AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY**

# CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

## NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70511031-00319-0

| | |
|---|---|
| **Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:** | **12/8503/26** |
| **Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:** | 04.05.2026 - 14:31 |
| **Komuna / Opština / Municipality:** | DEÇAN / DEČANE / DEÇAN |
| **Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:** | Dubovik / Dubovik / Dubovik |
| **Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:** | DEÇAN / DEČANE / DEÇAN |

## A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

| Numri i njësisë kadastrale<br>Broj katastarske jedinice<br>Cad. Unit. No. | Lloji i njësisë<br>Vrsta Jedinice<br>Unit Type | Lloji i pronës<br>Vrsta imovine<br>Property Type | Zona<br>U/R<br>G/S<br>U/R | Sipërfaqja<br>Površina<br>Area<br>(m²) | Përshkrim<br>Opis<br>Description | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **P-70511031-00319-0** | **PARCELË / PARCELA / PARCEL** | Pronë shoqërore / Drushtvena Imovina / Socially owned Land | Rural | **4463** | 7-2003 | | |

## A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE /CADASTRAL UNIT ADDRESS

| Vendi i quajtur<br>Mesto zvano<br>Called place | Kodi Postal<br>Poštanski Kod<br>Postal Code | Emri i rrugës<br>Naziv ulice<br>Street name | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|
| DUBOVIK-DUBOVIK | 0 | | | |

## A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

| Numri<br>Broj<br>Number | Lloji i shfrytëzimit të parcelës<br>Vrsta koriscenja parcele<br>Parcel Type Of Use | Shfrytëzimi aktual i parcelës<br>Trenutno koriscenje parcele<br>Parcel Current Use | Kualiteti i klasës<br>Kvalitet klase<br>Quality Class | Sipërfaqja (m²)<br>Površina (m²)<br>Area (m²) |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Bujqësore/Poljoprivredno/Agriculture | Kullosat/Pašnjaci/pasture | Kullosë E Klasës 2/Pasnjak 2 Klase/2nd Class Pasture | 4039 |
| 2 | Tokë Ndërtimore/Gradjevinsko zemljište/Construction land | Shtëpi-Ndërtese/Kuca-Zgrada/House-Building | | 424 |

## B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

| Të drejtat<br>Prava<br>Rights | Emri<br>Ime<br>Name | Nr. personal<br>Licni broj<br>ID. No. | Vendbanimi<br>Prebivaliste<br>Resident | Kodi postal<br>Poštanski kod<br>Postal code | Hollësitë e adresës<br>Pojedinosti adrese<br>Address details | Pjesa e pronës<br>Deo imovine<br>Share quota | Pershkrimi<br>Opis<br>Description | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor | **Komuna e Deçanit** | 600325668 | / / / | | JASHAR SALIHU | 1/1 | 7-2003 | |

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA
MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

## KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : DEÇAN

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Dubovik

| Njësia/Jedinica/Unit | Tipi/Vrsta/Type | Sipërfaqja/Površina/Area m² |
|---|---|---|
| P-70511031-00319-0 | Parcelë / Parcela / Parcel | 4463 |




Shkalla/Razmera/Scale: 1:1888

Punoi/Obradio/Created: Jetmir Avdiu

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note:

Data/ Data/Date: 04.05.2026

Koha/ Vreme/ Time: 02:36:53

00318-0
00582-4
00347-0
00582-2
00582-1
00339-2
00340-0
00336-1

Ne bazë të dispozitave të nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja d) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008, 04 Qershor 2008), dhe dispozitave të nenit 13 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës ( Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 10 / 03 prill 2019 ), si dhe nenit 6 te Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës si dhe nenit 22 dhe 26 pika 7 të Statutit të Komunës së Deçanit 01.Nr.IX-5 dt.31.10.2019, në bazë të kërkesës së MAPL-së të dt.27.03.2026, për Rishqyrtim të aktit komunal, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.30.04.2026, miratoi këtë:

# VENDIM
## PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E VENDIMIT MR NR. 01.Nr.II-5 TË DATËS 27.02.2026 PËR PUBLIKIMIN E LISTËS SË PËRGJITHSHME TË PRONAVE TË PALUAJTSHME TË KOMUNËS DHE MIRATIMIN PARAPRAK TË LISTËS SË VEÇANTË TË PRONAVE TË PALUAJTSHME TË KOMUNËS QË PLANIFIKOHEN PËR DHËNIE NË SHFRYTËZIM GJATË VITIT 2026

I.

Me këtë vendim plotësohet ndryshohet vetëm pjesa tabelore e Listës së Veçantë të pronave komunale që planifikohen të epen në shfrytëzim për vitin 2026.

II.

| Nr. | NR. i Parcelës | Zona Kadastrale | Titullari-Pronari | Sipërfaqja në $m^2$ | Destinimi Sipas PZHK-së | Qëllimi | Periudha kohore për dhënie në shfrytëzim |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 01. | **0893-0** | Deçan | Komuna e Deçanit | 3295 | **Banim i përhershëm ekzistues** | Një pjesë Eco-Tregu 700 $m^2$ | Afatshkurtë 15 vite |
| 02. | **01098-0** | Dranoc | Komuna e Deçanit | 107210 | **Industri** | Zonë ekonomike | Afatgjatë 99 vite |
| 03. | **01108-0** | Strellc i Ulët | Komuna e Deçanit | 4716 | **Banim me funksione tjera në pajtueshmëri** | Objekt banimi me afarizëm | Afatgjatë 99 vite |
| 04 | **01109-0** | Strellc i Ulët | Komuna e Deçanit | 5639 | **Banim me funksione tjera në pajtueshmëri** | Objekt banimi me afarizëm | Afatgjatë 99 vite |
| 05 | **01110-0** | Strellc i Ulët | Komuna e Deçanit | 2589 | **Banim me funksione tjera në pajtueshmëri** | Objekt banimi me afarizëm | Afatgjatë 99 vite |
| 06 | **01294-1** | Deçan | Komuna e Deçanit | 2099 626 | **Banim i përhershëm ekzistues** | Objekt banimi me afarizëm | Afatgjatë 99 vite |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 07 | **1256-0** | Deçan | Komuna e Deçanit | 337 | **Banim i përhershëm ekzistues** | Objekt banimi me afarizëm | Afatgjatë 99 vite |
| 08 | **1257-0** | Deçan | Komuna e Deçanit | 25 | **Banim i përhershëm ekzistues** | Objekt banimi me afarizëm | Afatgjatë 99 vite |
| 09 | **4690-2** | Deçan | Komuna e Deçanit | 7048 (Pjesë) | **Banim i përhershëm ekzistues** | Objekt banimi me afarizëm | Afatgjatë 99 vite |
| 10 | **00334-0** | Deçan | Komuna e Deçanit | 204 | **Pylltari e bazuar në rotacion të shkurtër** | Pylltari | Afatgjatë 40 vite |
| 11 | **00335-0** | Deçan | Komuna e Deçanit | 308 | **Pylltari e bazuar në rotacion të shkurtër** | Pylltari | Afatgjatë 40 vite |
| 12 | **00336-0** | Deçan | Komuna e Deçanit | 638 | **Banim i përhershëm ekzistues** | Objekt banimi me afarizëm | Afatgjatë 40 vite |
| 13 | **00337-0** | Deçan | Komuna e Deçanit | 1310 | **Banim i përhershëm ekzistues** | Objekt banimi me afarizëm | Afatgjatë 40 vite |
| 14 | **00341-0** | Deçan | Komuna e Deçanit | 1624 | **Banim i përhershëm ekzistues** | Objekt banimi me afarizëm | Afatgjatë 40 vite |
| 15 | **00342-0** | Deçan | Komuna e Deçanit | 12792 | **Banim i përhershëm ekzistues (një pjesë) Pylltari e bazuar në rotacion të shkurtër( një pjesë)** | Objekt banimi me afarizëm(një pjesë) Pylltari (një pjesë) | Afatgjatë 40 vite |
| 16 | **00593-0** | Deçan | Komuna e Deçanit | 4458 515 | **Banim i përhershëm ekzistues** | Objekt banimi me afarizëm | Afatgjatë 99 vite |
| 17. | **00594** | Deçan | Komuna e Deçanit | 3460 | **Banim i përhershëm ekzistues** | Objekt banimi me afarizëm | Afatgjatë 99 vite |
| 18. | **00595-0** | Deçan | Komuna e Deçanit | Pjesë e pronës | **Banim i përhershëm ekzistues** | Objekt banimi me afarizëm | Afatgjatë 99 vite |
| 19. | **00591-0** | Deçan | Komuna e Deçanit | Pjesë e Pronës | **Banim i përhershëm ekzistues** | Objekt banimi me afarizëm | Afatgjatë 99 vite |

III.

Pronat komunale të Komunës së Deçanit për dhënie në shfrytëzim për vitin 2026 të vendimit 01.Nr.II-5, të dt.27.02.2026, për të gjitha parcelat në listë janë të definuara destinimet dhe mënyra e shfrytëzimit, të njejtat janë të përfshira në Planin Zhvillimor Komunal (PZHK) 2024 - 2032, të miratuar me dt.27.02.2025.

IV.

Për zbatimin e këtij vendimi do të përkujdesen: Kuvendi i Komunës, Kryetari i Komunës si dhe Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër.

V.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale , si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në web faqen e Komunës.

01.Nr.IV-7
Deçan,dt.30.04.2026

Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ

Kuvendi Komunal 9029
01 13.05.26

Në bazë të dispozitave të nenit 40 paragrafi 40.2 shkronja e) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr.28/2008) dhe nenit 26 pika 9 të Statutit të Komunës së Deçanit 01.Nr.IX-5 të datës 31.10.2019, Kapitulli IV Përzgjedhja e Drejtorëve dhe Zëvendësdrejtorëve, Neni 14, paragrafi 7, paragrafi 8, nën paragrafi 8.1-Përbërja e Komisionit përzgjedhës, të Rregullore (QRK) Nr:19/2024 për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorëve dhe Zëvendësdrejtorëve, Mësimdhënësve, Bashkëpunëtorëve Profesional, Asistentëve, Instruktorëve dhe Sekretarëve në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore dhe Aftësuese (IEAA) të Arsimit Parauniverzitar, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e rregullt të mbajtur me dt.30.04.2026, me 12 vota "për", 8 vota"kundër" dhe 0 votë"abstenim", miratoi këtë:

# V E N D I M

## Për aprovimin e dy anëtarëve të komisionit për përzgjedhjen e Drejtorit/eshës në SHML "Vëllezërit Frashëri"-Deçan

I.

Me këtë vendim bëhet emërimi i dy anëtarëve të komisionit për përzgjedhjen e Drejtorit/eshës në SHML "Vëllezërit Frashëri"-Deçan, në këtë përbërje:

1. Zeqë Malaj nga DKA;
2. Florenta Molliqaj, përfaqësuese nga këshilli i prindërve në nivel komune dhe eksperte nga fusha e arsimit;
3. Një anëtar/e nga MASHTI, i cili përcaktohet nga MASHTI, pasi që ka marrë njoftim zyrtar, e-mail zyrtar nga DKA.

II.

Komisioni është përgjegjës për zhvillimin e procedurës së rekrutimit për përzgjedhjen e drejtorit/eshës në SHML "Vëllezërit Frashëri"-Deçan, konform procedurave të përcaktuara me Rregulloren (QRK) Nr:19/2024.

III.

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Drejtoria për Arsim e Komunës së Deçanit.

IV.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

V.

Me Vendim paisen të përmendurit në pikën I. Të Vendimit, Drejtoria për Arsim, Kryetari i Komunës dhe Arkivi.

01.Nr.IV-6
Deçan,dt.30.04.2026

Kuvendi Komunal 9024
01 13.05.26

Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ

Në bazë të Ligjit Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP) dhe Ligjit Nr.10/L-001 Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026, në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2 shkronja d), nenit 40 paragrafi 40.2 shkronja (b) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr.28/2008), nenit 26 pika 2. të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5, dt.31.10.2019, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.30.04.2026, me 12 vota"për", 8 vota"kundër" dhe 1 votë"abstenim" miratoi këtë:

# V E N D I M

## PËR BARTJEN E TË HYRAVE VETANAKE NGA VITI PARAPRAK 2025 NË VITIN AKTUAL FISKAL 2026

I.

Me këtë Vendim bëhet bartja e të hyrave vetanake nga viti paraprak 2025 në vitin aktual fiskal 2026, sipas LMFPP Nr.03/L-048 dhe Ligjit Nr. Nr.10/L-001 Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2026.

Totali për bartje është shuma **179,513.58 €**, siç paraqitet në pasqyrën e mëposhtme

- **Programi: Zyra e Kryetarit, Kategoria ekonomike: Mallra dhe Shërbime**
  → Bartet shuma totale prej **179,513.58 €**
  → **Kodi ekonomik: 21/631/16015/130/00000/0111 – shuma: 179,513.58 €**
  - **79,513.58 € nevoiten për hapjen e procedurave tenderuese për projektin për Mbështetje të Fermerëve me mekanizëm bujqësor;**
  - **100,000.00 € nevoiten për Blerjene e Makinerive ( Kamion) për NPL "Higjiena" SHA.**

II.

Për ekzekutimin e këtij vendimi do të kujdesen: - Zyra e Kryetarit, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe Drejtoritë tjera relevante të Komunës së Deçanit.

III.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

IV.

Me Vendim njoftohen: MF-Departamenti për Buxhet dhe Financa, MAPL, Zyra e Kryetarit, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoritë tjera relevante dhe Arkivi i Komunës së Deçanit.

01.Nr.IV-3
Deçan,dt.30.04.2026

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT

Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ

Kuvendi Komunal 9026
01 13.05.26